

01-1297



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Datë/a:	04.09.2023
Referenc-ë:	05-351/10-168971/23 dt.15.08.2023
Nga/ Od/ From:	Anita Osmani, zyrtare, Drejtoria e Urbanizmit
Për/ Za/ To:	Drejtoria e Kadastrit, Prishtinë
CC:	Muratori, Sh.p.k. Rr.Xheladin Shala, Glllogoc, Komoran
Përmes/ Preko/ Through:	Nazife Krasniqi, Udhëheqëse e sektorit, Drejtoria e Urbanizmit
CC:	Arber Sadiki, Drejtor, Drejtoria e Urbanizmit
Tema/ Sekat/Subject:	Dërgesë dokumentacioni



“Muratori, Sh.p.k. Rr.Xheladin Shala, Glllogoc, Komoran, me anë të ankesës 05-351/10-168971/23 dt.15.08.2023, i është drejtuar kësaj drejtori me kërkesën për ndërrimin e destinimit të parcelave kadastrale nr.1769-4, 1769-5, ZK.Prishtinë nga toka bujqësore “Arë e klasës 4”, në tokë ndërtimore.

Kjo drejtori pas shqyrtimit të kësaj kërkesë konstaton se bazuar në Vendimin 05 NR. 350/02-214775/22 DT. 26.06.2023, janë caktuar kushte ndërtimore palëve: Avdyl Shala, Remzije Shala, Naser Shala dhe Zyla Shala me Investitor: Muratori, Sh.p.k. Rr.Xheladin Shala, Glllogoc, Komoran, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore afariste me etazhitetb 2B+S+P+10+Ph, në parcelat ndërtimore: “E-19-3” dhe “E-19-4”, të bllokut urban “E-19”, të tërësisë hapësinore “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1769-4, 1769-5, ZK.Prishtinë.

Bazuar në Vendimin e kushteve ndërtimore gjegjësisht pikës XII të Vendimit 05 NR. 350/02-214775/22 DT. 26.06.2023, kjo drejtori ka dhënë pëlqimin për ndërrimin e destinimit të tokës sipas përshkrimit në atë pikë, andaj, konform nenit 128 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), të gjitha shkresat e lëndës, ua dërgojmë në kompetencën tuaj.

Shtojcë: Ankesën, Vendimin për përfundimin e procedurës 05 NR. 351/02-62131/22 DT. 22.03.2023

I dërgohet: MMPHI-së, kërkuessit, kësaj Drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

është përcjellur e
postë dt. 05.09.2023